



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2021:246875

Datë: 04.07.2024

Numri i dokumentit: 05900158

C.nr.321/2021

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni civil, gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.M. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurit I.K. nga, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, me vlerë të kontestit prej 211,97 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datën 19.06.2024 mori, ndërsa më datën 04.07.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit Xh.M. nga dhe DETYROHET i padituri I.K. nga, që në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar me datë 03.09.2021, duke i lëshuar bagëtitë e tij për kullosa në paluajtshmërinë e paditësit të mbjellë me misër dhe kunguj, edhe atë për 240 kg kunguj Misiri në shumë prej 194.40 € ($240 \times 0.81 = 194.40$) dhe 87.36 kg misër në shumë prej 17.47 € ($240 \times 0.20 = 17.47$) t'ia paguaj paditësit shumën në total prej 211.87 €, me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në afat prej 15 ditëve nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën e përgjithshme prej 199.00 euro, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi Xh. M. nga, përmes të autorizuarit të tij, më datën 27.10.2021, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit I.K. nga, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, me vlerë të kontestit prej 211.87 euro.

Pretendimet e palëve ndërgjyqësore

Paditësi, në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare, përmes të autorizuarit të tij, ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë kërkesëpadisë të dt.27.10.2021, të paraqitur në këtë gjykatë, dhe se është vërtetuar mjaftueshëm se me datë 03.09.2021, bagëtitë e të paditurit e kanë dëmtuar pronën e paditësit, kjo u vërtetua edhe nga dëshmia e dëshmitarit A. M., i cili është dëgjuar në këtë gjykatë, ndërsa sa i për ketë lartësisë së kompensimit ekziston raporti i ekspertëve të lëmisë përkatëse.

Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurin që t'ia kompensojë paditësit dëmin e shkaktuar për shkak lëshimit të bagëtitë në paluajtshmërinë e paditësit e cila ishte e mbjellë me misër dhe kunguj, shumën prej 211.87 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar, edhe atë: 20.00 € për taksë gjyqësore, 78.00 €, për përpilim të padisë si dhe 101.00 €, për përfaqësim në një seancë gjyqësore.

I padituri, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, dëshminë e dëshmitarit dhe provat-fotot ngase të njëjtat janë të nxjerra nga interneti e jo nga vendi i ngjarjes po ashtu e kundërshton edhe raportin e vlerësimit të përpiluar nga DBPZHR, meqë të njëjtit nuk i kanë ftuar të marrim pjesë me rastin e vlerësimit të dëmit, për çka është njoftuar në seancë.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, në shqyrtimin kryesor i ka administruar këto prova materiale: Raporti për vlerësimin e dëmit me nr.328, i datës 20.10.2021, I lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe fotografit nga vendi I ngjarjes

Gjykata nga dëshmitari A. M. vërtetoi faktet se, ara në të cilën ka parë numër të madh të lopëve është e Xh.M., pasi që të njëjtin e ka parë duke punuar, në të cilën arë ka pasur të mjellur, misër, kunguj dhe hotina, gjatë shkaktimit të demit lopët kanë qenë pa mbikëqyrje, më pas lopët i ka marr djali i të paditurit B. K., me çka ka vërtetuar se lopët janë të paditurit, në fshat numër aq të madh të lopëve ka pasur vetëm i padituri pasi që i njëjti ka pasur fermë të lopëve, fotografitë i ka bërë nga shtëpia e tij, paluajtshmërinë paditësi e shfrytëzon si arë dhe bahqe.

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të të autorizuarit të palës paditëse dhe të paditurit, si dhe provave materiale dhe personale, në kuptim të dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e bazuar në ligj. Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se me datë 03.09.2021, paditësit i është shkaktuar dëm material në paluajtshmërinë e tij, në të cilën kishte të mbjellun misër, kunguj dhe hotina, mirëpo kontestues ishte fakti se bagëtitë a ishin të paditurit apo jo.

Në bazë të vlerësimit të demit nga komisioni I DBPZHR, me nr.328, I dt.20.10.2021, gjykata vërtetoi faktin se komisioni ka konstatuar se dëmi I shkaktuar është 100% i kungullit dhe i misrit 70%, shprehur në vlerë monetare në shumë prej 211.87 euro.

Nga 3 fotografit, gjykata vërtetoi faktin se në tokën në të cilën ka pasur të mbjellur misër dhe pjesa tjetër me kungull, janë parë bagëti-lopë duke kullosur.

Gjykata dëshmisë së dëshmitarit A. M., ia falë besimin e plotë ngase e njëjta ishte objektive, e qartë dhe përkonte edhe me provat tjera materiale, nga e cila gjykata vërtetoi faktin se paluajtshmëria e dëmtuar ishte e paditësit në të cilën kishte të mbjellur misër, kunguj dhe hotina, ku ditën kritike kishte parë disa bagëti duke kullosur në arën e paditësit ku të njëjtave edhe iu kishte bërë disa fotografi, ngase shtëpia e të njëjtit është afër paluajtshmërisë së paditësit, bagëtia ishte pa mbikëqyrje të pronarit, mirëpo me vonë kishte parë djalin e të paditurit B. K. duke marrë bagëtitë, nga i cili kishte konstatuar se bagëtitë ishin të të paditurit I.K..

Baza juridike

Me nenin 136 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, (LMD-së), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, paragrafi 2 *“Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji”*, në nenin 137 se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur); në nenin 140* se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*; nenin 169, paragrafin 1 dhe 2 se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”* Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pakujdesia. Në rastin konkret i padituri nuk i ka ofruar prova gjykatës që do të provonin se dëmi ndaj paditësit është shkaktuar pa fajin e tij. Andaj, duke marrë parasysh bazën ligjore të lartë-cituar, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Sipas bindjes së kësaj gjykate pretendimet e palës paditëse, janë të bazuara pasi që u vërtetua se me datë 03.09.2021, i padituri ka lëshuar bagëtitë e tij, të cilat kanë hyrë në paluajtshmërinë e paditësit në të cilën kishte të mbjellë misër dhe kunguj të misirit, e që paditësit i kanë shkaktuar dëm material, në shumë pre 211.87 euro.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Lidhur me këtë çështje kontestimore dhe për vendosjen në mënyrë sa më të drejtë dhe ligjore, gjykata ka marrë për bazë vlerësimin e dëmit nga DBPZHR, e në veçanti për t’iu përgjigjur dilemës se bagëtit a kanë qenë të paditësit, fakt të cilin e vërtetoi nga dëshmitari I lartcekur nga I cili u vërtetua se ditën kritike bagëtitë kishte ardhur ti marrë djali I tani të paditurit, ndërsa gjykata sa i për këtë lartësisë së kompensimit është bazuar në vlerësimin e dëmit nga komisioni I ekspertëve nga DPZHR, në Komunën e Kamenicës, me të cilën kanë konstatuar se paditësit I është shkaktuar dëm në lartësi prej 211.87 euro, edhe atë për dëmtimin e 100% të misrit dhe 70% të kungujve të misirit.

Duke i marrë parasysh provat materiale të administruara, si dhe dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se bagëtitë e të paditurit me dt.03.09.2021, kanë dëmtuar të mbjellat e paditësit në paluajtshmërinë e tij, me ç’rast i është shkaktuar dëm edhe atë 194.40

euro, nga kultivimi I kungullit të misirit si dhe shumën prej 17.47 euro për kultivimin e misrit, këto në shumë prej 211.87 euro.

Mbi bazën e kësaj gjendjeje faktike, gjykata vlerësoi se padituri I. K., mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësit me rastin e dëmtimit të të mbjellave, për çka i padituri është i obliguar që paditësit t'ia kompensojë dëmin e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kamata ligjore prej 8 % është përcaktuar komfor nenit 382 të LMD-ës, me të cilën dispozitë materiale është përcaktuar shprehimisht se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën. Lartësia e kamatë vonesës është 8 % në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Gjykata sa i për ketë kamatës ligjore u bazuar në nenin 382 paragrafi 2 të LMD-së, dhe obligojë të paditurin, që paditësit t'ia paguajë shumën e gjykuar të kompensimit së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 8 %, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, këtë duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik për Kamatën nr.265/2020, të dt.02.12.2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 452, paragrafi 1, të LPK-së, si dhe në bazë të tarifës së zbatuar të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe e detyrojë të paditurin, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 199.00 euro. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila i përgjigjet shpenzimeve të shkaktuara në këtë procedurë gjyqësore si në vijim: për përpilimin e padisë shumë prej 78.00 euro, për taksën për padi shumë prej 20.00 euro, për përfaqësim në 1 seancë gjyqësore shumë prej 101.00 euro.

Duke u bazuar në të lartë cekurat, si dhe në dispozitat e nenit 136 paragrafi 1, dhe nenit 140 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, si dhe në dispozitën e nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:246875, 04.07.2024**

Gjyqtarja,

Valbonë Dërvodeli,d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.